



**NJOFTIM PËR TË GJITHË KREDITORËT DHE PRONARËT E NDËRMARRJES**

**MIT024 Prva Petoletka PTT – Leposavić**

Emrat alternativë/emrat e mëparshëm dhe numrat e regjistrimit:  
RO IHP Prva Petoletka (1988)  
PPT Zglobni Lezajevi DD (1993)

Në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe nenit 7 të Shtojcës të këtij ligji, **NJOFTOHENI** se Likuidimi i Ndërmarrjes së lartpërmendur ka filluar me datë 15 shkurt 2017 në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të datës 30 janar dhe 14 shkurt 2017.

**Çdo person i cili pretendon se ka të drejtë kërkesë dhe/apo interesi ndaj kësaj ndërmarrjeje apo aseti të ndërmarrjes duhet të parashtrorë Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit sipas nenit 7 dhe nenit 23 të Shtojcës të Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në.**

**Afati për parashtrimin e kërkesave kreditore fillon me datë 22 shkurt 2017 dhe përfundon me datë 11 prill 2017 në orën 16:00.**

**Ftoheni që të parashtroni Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit pavarësisht nëse më herët mund ta keni informuar Agjencinë Kosovare të Privatizimit apo pararendësin e saj. Nëse nuk parashtroni Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit brenda afatit kohor të lartë cekur, pretendimet tuaja do të refuzohen si të papranueshme bazuar në nenin 35 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në. Mosdorëzimi i dokumentacionit në mbështetje të kërkesës tuaj apo mosplotësimi i rregullt i formularëve, gjithashtu do të rezultojë në refuzimin e pretendimeve tuaja.**

**Formularët për Dëshminë e Kërkesës si dhe Dëshminë e Interesit mund të merren në të gjitha zyrat e AKP-së dhe duhet të dorëzohen në Zyrën Rajonale të AKP-së çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në ora 14:00 në adresën si më poshtë.**

**Agjencia Kosovare e Privatizimit Zyra Rajonale në Mitrovicë**  
**Mbretëresha Teutë, pn** (afër Sallës së Sporteve),  
**Mitrovicë, 40 000**  
**Telefoni: +381 28 534 690**  
**Fax: +381 28 534 590**

Formularët për parashtrim të Dëshmisë së Kërkesës dhe Dëshmisë së Interesit gjithashtu mund të shkarkohen edhe nga faja e internetit të AKP-së në adresën [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org). Për udhëzime se si të plotësohen dhe dorëzohen këta formularë referohuni tek seksioni **“Formularët-Udhëzime për plotësim”**. Formularët e dorëzuar përmes postës elektronike nuk do të pranohen.